



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data
07.12.2020

RELACION

PËR PROJEKTVENDIMIN “PËR MIRATIMIN E MODELIT DHE SPECIFIKIMEVE TË VULAVE ME KOD SIGURIE QË DO TË PËRDOREN NË ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS 25 PRILL 2021”

Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, bazuar në kompetencat e parashikuara në nenin 19, paragrafi 1, shkronja “b” dhe “n”, të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, i paraqitet për shqyrtim dhe miratim projektvendimi “Për miratimin e modelit dhe specifikimeve të vulave me kod sigurie që do të përdoren në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021”.

Ligji Nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 99, përcakton detyrimin e KQZ-së për dërgimin në KZAZ të materialeve zgjedhore për çdo qendër votimi. Neni 99, paragrafi 2, shkronja “b”, përcakton se KQZ dërgon në KZAZ numër të mjaftueshëm kodesh sigurie, sipas vendimit të KQZ-së.

Referuar eksperiencës të organizimit dhe administrimit të proceseve zgjedhore, vulat me kode sigurie të miratuar, prodhur, dhe përdorur nga KQZ kanë garantuar integritetin e materialeve sensitive të votimit siç janë kutitë e votimit me fletët e votimit dhe kutitë e materialeve të votimit, sikundër edhe është dëshmuar lehtësi në administrimin dhe përdorimin e tyre nga komisionerët zgjedhorë, gjatë shpërndarjes, kryerjes së procedurave në qendrën e votimit, si dhe gjatë procesit të numërimit të votave.

Projektvendimi që paraqitet për shqyrtim dhe miratim, parashikon që për zgjedhjet për Kuvend të datës 25.04.2021, vulat me kode sigurie, përfshirë edhe vulat me kode sigurie rezervë:

- a) të kenë trup prej materiali plastik, me ngjyrë, brenda të cilit ndodhet pllaka metalike që garanton mbylljen e sigurtë :
 - i. vulat me kod sigurie që do të përdoren për mbylljen e kutive të votimit dhe kutive të materialeve të votimit të kenë trup plastik me ngjyrë të bardhë;
 - ii. vulat shtesë me kod sigurie që do të përdoren për mbylljen e kutive të votimit dhe kutive të materialeve zgjedhore të kenë trup plastik me ngjyrë të verdhë.

- b) në trupin e vulës do të stampohet kodi i sigurisë me ngjyrë jeshile;
- c) kodi i sigurisë do të jetë KQZ dhe një numër unik gjashtë shifror për çdo vulë;
- ç) mbyllja e vulës me kod sigurie do të bëhet me kavo çeliku të galvanizuar, i cili mund të këputet vetëm me përdorimin e një pinçe të posaçme.

Ana TENOLLI – Drejtorja e Komisioneve dhe Materialeve Zgjedhore

Madalena KOJA – Drejtorja Juridike dhe e Dokumentacionit Zgjedhor

Ylli MERKAJ – Sekretar i Përgjithshëm